

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K

Sot në Tiranë, më datë 25/09/2018, hartuan dhe nënshkruan këtë akt-themelimi (në vijim referuar si “*Akti i Themelimit*”), palët e mëposhtme:

- **Shoqëria “Goldnalt” Sh.p.k**, e regjistruar si person juridik prane QKB më datë 04/07/2017, me NUIS L71904003A, me adresë selie kryesore në Shkodër, Lagjia Qemal Stafa, Rruga 13 Dhjetori, përfaqësuar nga Administratori Z. Emiljan Tanushi, shtetas shqiptarë, lindur më 12/09/1985, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal I50912031M.
- **Shoqëria “Rafaelo 2002” SH.A**, person juridik i së drejtës shqiptarë, regjistruar në regjistrin tregtar në QKR më datë 13.09.2002 me seli në Rr. “29, nentori”, Laprake, Tiranë, me NIPT k22113003q, përfaqësuar nga **Administratori Z. Eduart Gjinaj**, i datëlindjes 06.03.1964 lindur ne Pukw dhe banues në Lezhw, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi elektronik me nr. 026368403 me nr. personal G40306030B;

(në vijim së bashku referuar si “*Themeluesit*”).

Themeluesit janë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë ata ranë dakort me hartimin e këtij Akti Themelimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar, sipas kushteve të mëposhtme.

PREAMBULA

Duke marrë në konsideratë se ne, Themeluesit, duam të ushtrojmë veprimtari ekonomike dhe kemi për qëllim arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë dhe bashkuar kontributet tona në një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me qëllimin final për të prodhuar dhe ndarë përfitim ekonomik.

Ne, të nënshkruarit, shoqëria “Goldnalt” SH.P.K, identifikuar nga ekstrakti i regjistrit tregtar, përfaqësuar nga Administratori Z. Emiljan Tanushi, dhe shoqëria “Rafaelo 2002” SH.A, identifikuar nga ekstrakti i regjistrit tregtar, përfaqësuar nga Administratori Z. Eduart Gjinaj, me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe në dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartuam këtë akt, me qëllim për të deklaruar themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptarë, me emrin “**PROPER SHËNGJIN” SH.P.K.**

Atëherë, duke marrë në konsideratë sa më lart, ne, të nënshkruarit, shoqëria “Goldnalt” SH.P.K, përfaqësuar nga Administratori Z. Emiljan Tanushi dhe shoqëria **Shoqëria**



“Rafaelo 2002” SH.A., identifikuar nga ekstrakti i regjistrit tregtar, përfaqësuar nga Administratori Z. Eduart Gjinaj, si Themelues, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe në dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, jemi dakort me hartimin e këtij Akti-Themelimi dhe me përmbajtjen e tij.

ATËHERË, duke marrë në konsideratë sa më lart, për të cilat Themeluesit janë dakort dhe nuk kanë pretendime, Themeluesit bien dakort për hartimin dhe përmbajtjen e këtij Akti-Themelimi si më poshtë.

Neni 1 Forma - Emri – Selia

- 1.1 Shoqëria tregtare do të jetë e formës *shoqëri me përgjegjësi të kufizuar* dhe do të ketë emrin **“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K.**
- 1.2 Shoqëria **“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K** do të ketë selinë në Rr. “Shengjin”, ndërtesa nr.3, Njësia administrative Shengjin, Republika e Shqipërisë. Adresa e selisë së shoqërisë do të përcaktohet edhe në statutin e saj dhe mund të ndryshojë në të ardhmen me vendim të organeve vendimmarrëse përkatëse.

Neni 2 Parimet - Kohëzgjatja

- 2.1 Shoqëria **“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K** do të jetë dhe do të funksionojë si një shoqëri tregtare, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e pavarur nga Shteti dhe nga institucionet e Shtetit shqiptar dhe/ose partitë politike, si dhe e pavarur nga çdo organizatë apo organizëm tjetër i së drejtës publike apo private.
- 2.2 Shoqëria **“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K** do të punojë bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së ndershme. Funksionimi i shoqërisë **“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K** do të funksionojë bazuar në parimin e detyrimit të besnikërisë, në parimin e të drejtës së informimit, në parimin e ndalimit të abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë, në parimin e ndalimit të konkurrencës së pandershme, në parimin e sekretit tregtar, siç rezultojnë nga dispozitat 14 deri 18 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në çdo parim tjetër që komandohet nga zakonet dhe marrëdhëniet e mira tregtare, si dhe në Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare (Corporate Governance Code), siç është miratuar me vendimin nr. 1, datë 02.12.2011 të Këshillit Konsultativ të Biznesit.
- 2.3 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë **“PROPER SHËNGJIN” SH.P.K** do të jetë pa afat të përcaktuar.



2.4 Veprimtaria e shoqërisë "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K do të bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe/ose marrëveshjet ndërkombëtare që do të ratifikohen në të ardhmen, legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në veçanti atë për shoqëritë tregtare, në Statutin dhe Akt-Themelimin e saj, si dhe në rregulloren e markës tregtare "Proper Pizza", të drejtat ekskluzive territoriale të së cilës mbahen nga ortaku shoqëria "Goldnalt" SH.P.K. Për të mënjeluar çdo dyshim, rregullorja e markës tregtare "Proper Pizza", të drejtat ekskluzive të së cilës mbahen nga ortaku shoqëria "Goldnalt" SH.P.K, ka vlerën e një norme juridike të detyrueshme për zbatim nga shoqëria "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K dhe imponohet dhe është e detyrueshme për zbatim përgjatë veprimtarisë së shoqërisë "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K, siç është dhe siç mund të ndryshohet në të ardhmen nga pronari dhe mbajtësi i të drejtave.

2.5 Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, Themeluesit, Ortakët, Administratori, si dhe punonjësit e shoqërisë "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K, nuk përgjigjen individualisht/personalisht apo solidarisht për detyrimet e kësaj të fundit ndaj personave të tretë (persona fizikë apo persona juridikë), por mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Vetëm shoqëria "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K, e pajisur sipas ligjit me personalitetin juridik të nevojshëm, është përgjegjëse për detyrimet e saj ndaj personave të tretë (persona fizikë apo persona juridikë).

2.6 Themeluesit do të japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të parashikuara në statutin e shoqërisë, si dhe do të kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", si dhe të dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj të gjithë aktivitetet e mundshme që nuk ndalohen me ligj, dhe që do të përcaktohen në detaje në statutin e shoqërisë.

Neni 4 Kapitali - Përfaqësimi - Organet e Shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë kapitalin të përcaktuar në statutin e saj, sipas kontributeve të Themeluesve të saj në para dhe/ose në natyrë. Në çdo rast, ky kapital nuk mund të jetë më i vogël se 100 Lekë.



4.2 Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorja Znj. Miknela GJINAJ, atësia Mark, lindur dhe banuese në Tiranë, datelindja 05/11/1998, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, e identifikuar me ID me nr.032847156 dhe nr. Përsional J86105040Q sipas rregullave të përcaktuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe sipas rregullave të statutit.

4.3 Rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë "PROPER SHËNGJIN" SH.P.K, parashikohet në statutin e saj, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Bërë në Tiranë, më datë 25.04.2018, në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën shqipe secila me të njëjtën vlerë juridike.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË
"PROPER SHËNGJIN" SH.P.K**

Shoqëria "GOLDANLT" SH.P.K

Shoqëria "Rafaelo 2002" SH.A

Administratori

Z. Emiljan Tanushi

Emiljan Tanushi



Administratori

Z. Eduart Gjinaj

Eduart Gjinaj





Elona SYLA
Notere



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Notere Elona A. SYLA

Nr. 1064/Rep

VËRTETIM

Ne Tirane, sot, me date 04/05/2018 (*Dymije e tetembëdhjetë*) para meje Noteres Elona A. Syla, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën "Rr. Shyqyri Bërçolli", Pall. "Aurora", Kt.2, Tiranë, u paraqit personalisht:

1. Shoqeria "Goldnalt" Shpk, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me nr. L71904003A Nipti, e perfaqesuar nga Administratori i saj **Z. Emiljan TANUSHI**, i datelindjes 12.09.1985, lindur ne Vau Dejes, Shkoder dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjefotimin me nr. 025676619 dhe nr. I50912031M personal, me date leshimi 20.05.2009;

2. Shoqeria "Rafaelo 2002" Sha, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me nr. K22113003Q, i perfaqesuar nga Administratori i Shoqerise **Z. Eduart GJINAJ**, i datelindjes 06.03.1964, lindur ne Lumbardhe, Puke dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjefotimin me nr. 0263684403 dhe nr. G40306030B personal, me date leshimi 11.06.2009;

Te cilet në cilësinë e themelueseve të Shoqerise "Proper Shëngjin" Sh.p.k konfirmuan nënshkrimin e tyre ne Aktin e Themelimit te dates 25.04.2018, per krijmin e kesaj shoqerie me pergjegjesi te kufizuar si më sipër, me vullnetin e tyre te lire e te pavesuar, dhe une noteri pasi u binda për identitetin e tyre nëpërmjet dokumenteve individuale qe mbanin me vete i vërtetoj ato sipas kompetencave që parashikon neni 55 i ligjit 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", i ndryshuar. Unë noterja, në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), deklaroj se do të ruaj dhe përpusoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akt noterial/vertetim noterial në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
ELONA A. SYLA
NIPT: L71904003Q